



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2448/1 Prot.

Tiranë, më 20.10.2025

VENDIM

Nr. 307, Datë 10.10.2025

**“PËR RIEMËRIMIN E PROKURORIT ALBERT MURÇAJ NË POZICIONIN
DREJTUES NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Artë MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Valtë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen plenare të datës 10.10.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për riemërimin e prokurorit Albert Murçaj në pozicionin Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2448, dt. 02.10.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, pasi dëgjoi relatorin znj. Ledina Riza si dhe diskutimet e zhvilluara në mbledhje plenare mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*në vijim Këshilli*) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (*në vijim, Ligji për Statusin*), në nenin 47, pika 1, të tij, parashikon, se: "**1. "Ngritja në detyrë" është kalimi nga: a) një pozicion në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në një pozicion tjetër të një niveli më të lartë; b) një pozicion i juridiksionit të përgjithshëm civil, penal ose administrativ në një pozicion në një prej gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme; c) një pozicion si magjistrat, në pozicionin e kryetarit të një gjykate ose prokurorie; ç) një pozicion i komanduar ose pozicion në skemën e delegimit, në një pozicion të një niveli më të lartë sesa pozicioni i mbajtur para komandimit.**
3. Siç rezulton nga formulimi i mësipërm, një nga rastet që klasifikohet si *ngritje në detyrë* e një prokurori, është edhe emërimi i tij si kryetar/drejtues i një prokurorie. Ky proces ka të bëjë me zhvillimin e karrierës së magjistratit.
4. Bazuar në këtë të drejtë dhe mbi bazën e aplikimit të paraqitur, pranë Këshillit është administruar nr. 982 prot., datë 04.04.2024, Kërkesa e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, z. Albert Murçaj, i cili, mbështetur në nenin 52, pika 2, të Ligjit për Statusin, ka paraqitur kërkesë për të kandiduar për një mandat të dytë në pozicionin e drejtuesit të kësaj prokurorie.
5. Prokurori Albert Murçaj është zgjedhur në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me Vendimin nr. 311, datë 04.10.2021, "*Për caktimin e z. Albert Murçaj, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër*". Në këtë vendim është vendosur që prokurori Albert Murçaj të ushtrojë funksionin e drejtuesit në këtë zyrë të prokurorisë për periudhën 04.10.2021-03.10.2024.
6. Rezulton se nga data e përfundimit të mandatit të rregullt tre vjeçar (03.10.2024), z. Albert Murçaj ka vijuar të kryejë detyrën si Drejtues në Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, përmes *caktimit të përkohshëm*, respektivisht me vendimet:
 - i. Vendim nr. 206, datë 30.09.2024, "Për caktim të përkohshëm";
 - ii. Vendim nr. 269, datë 23.12.2024, "Për caktim të përkohshëm të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër";
 - iii. Vendim nr. 47, datë 20.03.2025, "Për caktimin e përkohshëm";

- iv. Vendim nr. 116, datë 23.06.2025, “Për caktim të përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”;
 - v. Vendim nr. 291, datë 24.09.2025, “Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”.
7. Bazuar në sa më sipër, periudha e ushtrimit të detyrës si Drejtues në këtë zyrë të prokurorisë nga prokurori Albert Murçaj, përmes caktimit të përkohshëm nga dita e përfundimit të mandatit të rregullt tre vjeçar deri në ditën e sotme është rreth 1 vit.
 8. Ligji për Statusin, në nenin 51, pika 1, parashikon, se: *“Mandati i Kryetarit të gjykatave dhe prokurorisë të tjera, me përjashtim të Prokurorit të Përgjithshëm, është 3 (tre) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë”*.
 9. Pas administrimit të Kërkesës së mësipërme, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës verifikoi plotësimin e kushteve të nenit 52, pika 2, të ligjit të mësipërm, ku parashikohet se:

[....] 2. “Jo më vonë se 6 muaj përpara mbarimit të mandatit të parë, kryetari i gjykatës ose prokurorisë me të drejtën e rizgjedhjes, mund të kandidojë për një mandat të dytë. Kur kryetari nuk kandidon për një mandat të dytë brenda afatit të përcaktuar, konsiderohet që ka dhënë dorëheqjen si kryetar në fund të mandatit.”
 10. Meqënëse Kërkesa e prokurorit Albert Murçaj për rikandidim për një mandat të dytë në pozicionin e Drejtuesit të zyrës së Prokurorisë Shkodër është paraqitur brenda afatit ligjor, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ia përcolli atë Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale i cili, në zbatim të nenit 52, pikat 3 dhe 4, të Ligjit për Statusin, kryen procedurat e verifikimit të figurës dhe pasurisë si dhe të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatit për Drejtues.

Në këto dispozita parashikohet se: *“3. Kur kryetari në detyrë kandidon për riemërim, i nënshtrohet verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshilli përkatës, jo më vonë se tre muaj para mbarimit të mandatit të parë, sipas rregullave të parashikuara në pikat nga 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. 4. Kryetari riemërohet për një mandat tjetër vetëm nëse kalon me sukses verifikimin, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji, dhe nëse vlerësimi për veprimtarinë si kryetar dhe magjistrat, është të paktën “shumë mirë”*.
 11. Referuar kësaj baze ligjore, për procesin e rikandidimit kërkohet që të zhvillohet procesi i verifikimit të pasurisë dhe figurës si dhe ai i vlerësimit etik dhe profesional të kandidatit për Drejtues të prokurorisë, vlerësimi këto që duhet të kenë përfunduar përpara se Këshilli të shprehet për riemërimin ose jo të tij.

12. Për rrjedhojë, prokurori Albert Murçaj i është nënshtruar procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës si dhe vlerësimit etik dhe profesional si Drejtues i Prokurorisë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për periudhën 2021 – 2024.
13. Këto dy procese që zhvillohen nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale konsiderohen komplekse për shkak të ndërveprimit dhe sigurimit të informacionit nga një numër i konsiderueshëm i institucioneve publike.
14. Në vijim të realizimit të këtyre dy proceseve, bazuar në nenet 32, 52 dhe 96, të Ligjit për Statusin, në Kreun V, Seksionin A, pikën 2, të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve” i ndryshuar, nenin 9 pika 4 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe neneve 11, 12 dhe 15 të Rregullores “Për vlerësimin e drejtuesit të prokurorisë të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli ka miratuar vendimet si vijon:
- i. Me Vendimin nr. 264, datë 12.12.2024, “Për verifikimin e pasurisë dhe figurës të prokurorit Albert Murçaj, kandidat për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”, Këshilli ka vlerësuar të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për prokurorin Albert Murçaj dhe ka lejuar kandidatin të vijojë me procedurën e ngritjes në detyrë në pozicionin e mësipërm.
 - ii. Me Vendimin nr. 299 , datë 01.10.2025, “Për miratimin e raportit të vlerësimit si Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, z. Albert Murçaj”, Këshilli ka miratuar Raportin e vlerësimit etik dhe profesional ku prokurori Albert Murçaj është vlerësuar “Shumë mirë”, me 193 pikë.
15. Pas përfundimit të proceseve të mësipërme administrative dhe përfundimit të tyre në përputhje me kriteret ligjore, Komisioni Zhvillimit të Karrierës, në mbledhjen e datës 02.10.2025 vendosi që t’i propozojë Këshillit riemërimin e prokurorit Albert Murçaj në pozicionin Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për një mandat 3 (tre) vjeçar.
16. Nga përmbajtja e Relacionit, ku bazohet ky propozim, rezulton se Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ndërkohë që ka propozuar unanimisht riemërimin e prokurorit z. Albert Murçaj si Drejtues i Prokurorisë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ka qenë i ndarë, përse i përket periudhës se *kur duhet që të fillojë të llogaritet mandati për këtë riemërim.*
17. Për këtë, në relacionin e paraqitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës parashtrohet se:

“Anëtarët në shumicë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës (z. Sokol Stojani dhe znj. Ledina Riza) janë të mendimit se, me riemërimin e prokurorit Albert Murçaj në pozicionin

Drejtues në zyrën e prokurorisë Shkodër, mandati 3-vjeçar duhet të fillojë të llogaritet në datën e miratimit të vendimit të riemërimit nga Këshilli dhe përfundon pas 3 (tre) vitesh.

Ndërsa, në pakicë, anëtarja e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, znj. Mirela Bogdani arsyetoi se, pas riemërimit, fillimi i mandatit tjetër të prokurorit Albert Murçaj si Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, të përlllogaritet duke filluar nga data e nesërme e plotësimit të kohës të mandatit të parë si Drejtues ose data 04.10.2024. Ky qëndrim mbështetet në nenin 52, pika 1, të Ligjit për Statusin, ku parashikohet:

“1. Mandati i Kryetarit të gjykatave dhe prokurorive të tjera, me përjashtim të Prokurorit të Përgjithshëm, është tre vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë...”

Sipas këtij qëndrimi të znj. Bogdani, periudha 3-vjeçare e mandatit si drejtues pas riemërimit duhet të përfshijë edhe periudhën aktuale gjatë së cilës, prokurori Albert Murçaj është caktuar përkohësisht si dhe ka ushtruar funksionet si drejtues në këtë zyrë prokurorie. Për rrjedhojë, mandati i dytë si Drejtues në këtë zyrë prokurorie i prokurorit Albert Murçaj, pas riemërimit duhet të përfundojë në datë 04.10.2027.

Në përfundim, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, me shumicën e anëtarëve të tij, i propozoi Këshillit:

- *Riemërimin e prokurorit Albert Murçaj në pozicionin Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për një mandat tre vjeçar.”*

18. Bazuar në sa më sipër, shumica në Komisionin e Zhvillimit të Karrierës, respektivisht z. Sokol Stojani dhe znj. Riza kanë mbajtur qëndrimin se, mandati tjetër tre vjeçar si Drejtues për prokurorin Albert Murçaj duhet të jetë i plotë, duke filluar efektet e këtij mandati nga dita e miratimit të vendimit për riemërim nga ana e Këshillit.

19. Ndërsa, anëtari në pakicë në këtë Komision, znj. Mirela Bogdani mban qëndrimin se, mandati i dytë tre vjeçar si Drejtues për kandidatin duhet të fillojë të llogaritet nga momenti që z. Albert Murçaj ka plotësuar mandatin e parë në këtë funksion ose data 03.10.2024, duke konsideruar si pjesë të këtij mandati edhe periudhën e mëvonshme të caktimit të përkohshëm në detyrën si Drejtues.

Vlerësimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë

20. Në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, Këshilli mori në shqyrtim propozimin e ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke arsyetuar dhe vendosur për riemërimin si Drejtues të prokurorit Albert Murçaj dhe për momentin e llogaritjes/fillimit të mandatit të tij, si vijon.

I

Në lidhje me riemërimin e prokurorit, z. Albert Murçaj, si drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

21. Këshilli konstaton, se ndodhet përpara rastit të parë të *riemërimit* të një magjistrati në funksionin e kryetarit/drejtuesit të një prokurorie. Për analogji, rezulton se, edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka asnjë praktikë të ngjashme për riemërimin e kryetarëve të gjykatave, pavarësisht se neni 52, i Ligjit për Statusin është i zbatueshëm, si për rastet e kryetarëve të gjykatave ashtu edhe për drejtuesit e prokurorive.
22. Për këtë arsye, Këshilli e sheh të nevojshme që të ndalet fillimisht në analizën dhe natyrën e procesit të riemërimit të kryetarëve/drejtuesve dhe, më pas, të vijojë të shprehet në lidhje me riemërimin e prokurorit, z. Albert Murçaj, si Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
23. Këshilli vëren, se procesi i riemërimit të një prokurori në pozicionin e drejtuesit të një prokurorie është një procedurë e posaçme, e parashikuar nga Ligji për Statusin, që synon garantimin e stabilitetit dhe pavarësisë institucionale të strukturave të akuzës, duke ruajtur njëkohësisht standardet e kontrollit të integritetit dhe performancës së magjistratit, që synon mandatin e dytë drejtues.
24. Neni 52, i këtij ligji parashikon qartë, se drejtuesit e prokurorive (me përjashtim të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të Prokurorisë së Posaçme) gëzojnë një mandat të kufizuar 3 (tre)-vjeçar, me të drejtë *riemërimi* vetëm *një herë*. Kjo dispozitë krijon një format institucional, që ndan qartë mes mandatin të parë dhe atij të dytë, duke i lidhur ato me kritere shtesë vlerësimi dhe kontrolli, ndryshe nga procesi fillestar i emërimit.
25. E parë në këtë aspekt, Këshilli vlerëson se procesi i emërimit në detyrën e Drejtuesit, i cili përfaqëson *ngritje në detyrë*, sipas neni 47, pika 1, germa “c”, të Ligjit për Statusin, realizohet nëpërmjet një procedure konkurruese të hapur, me thirrje publike dhe vlerësim mbi bazë skeme pikësh. Kandidatët përzgjidhen mbi bazë të vlerësimeve ekzistuese, përvojës profesionale dhe kritereve të tjera ndihmëse.
26. Në dallim nga procesi i *emërimit*, rezulton se procesi i *riemërimit* nuk është proces konkurrues, por procedurë e drejtpërdrejtë e vlerësimit individual të drejtuesit aktual, i cili, brenda afatit 6 (gjashtë) - mujor para skadimit të mandatin, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për riemërimin e tij. Ky afat është prekluziv dhe mosrespektimi i tij konsiderohet *dorëheqje* nga synimi për mandat të dytë.
27. Duke u bazuar në përmbajtjen e nenit 52, të Ligjit për Statusin, rezulton se procesi i riemërimit ka dy përbërës thelbësor dhe më konkretisht:
- Verifikimi i pasurisë dhe figurës;
 - Vlerësimi etik dhe profesional si drejtues dhe si magjistrat, ku niveli minimal i pranueshëm është “Shumë mirë”.

28. Këto dy elementë nuk aplikohen me të njëjtën formë tek kandidati që aplikon për herë të parë në pozicionin e drejtuesit. Kandidatët e rinj i nënshtrohen vlerësimit mbi bazë të performancës së tyre si prokurorë, pa realizuar një analizë të posaçme mbi ushtrimin prej tyre të funksioneve drejtuese.
29. Përkundrazi, në procesin e riemërimit, ndryshe nga ai i emërimit, rezulton që të jetë vazhdim i një funksioni të ushtruar tashmë, por i kushtëzuar nga rezultatet e verifikimeve. Riemërimi është një e drejtë kushtëzuese dhe meritokratike, sipas të cilit Këshilli ripohon ose jo besimin e tij në aftësinë drejtuese të prokurorit që rikandidon për pozicionin e kryetarit/drejtuesit të asaj prokurorie. Për rrjedhojë, procesi i riemërimit ka funksion kontrolli cilësor mbi drejtuesin, për të garantuar se ai/ajo ka vepruar me integritet dhe efikasitet.
30. Veçantia e kësaj procedure qëndron, gjithashtu, edhe tek fakti se për këtë proces nuk ka shpallje publike nga ana e Këshillit, nuk ka konkurrencë dhe nuk ka renditje midis kandidatëve të ndryshëm. Përkundrazi, rezulton se në këtë procedurë ka vetëm një kandidat, drejtuesi aktual, i cili nëse plotëson dy kushtet e mësipërme (*verifikimi pozitiv të pasurisë dhe figurës, si edhe vlerësim etik dhe profesional minimal "Shumë mirë"*), riemërohet në atë pozicion me vendim të Këshillit.
31. Këshilli, bazuar në normat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë procesin e riemërimit të një kryetari/drejtuesi prokurorie, si edhe në rrethanat faktike të cituara dhe analizuara më sipër në këtë vendim, konkludon se prokurori, z. Albert Murçaj, përmbush në mënyrë të plotë të gjitha kërkesat ligjore, procedurale dhe substanciale të parashikuara për t'u riemëruar në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Nga një vështrim i përmbledhur i të gjithë dokumentacionit të paraqitur dhe nga përmbajtja e dispozitave të Ligjit për Statusin, rezulton se ky prokuror i ka respektuar kriteret ligjore, si dhe ka treguar një standard të lartë profesionalizmi dhe integriteti gjatë ushtrimit të funksionit të tij.
32. Në përputhje me nenin 52, të këtij ligji, drejtuesit e prokurorive kanë të drejtë të kandidojnë për një mandat të dytë, por kjo e drejtë është e kushtëzuar nga disa kërkesa strikte.

Së pari, kërkesa për riemërim duhet të paraqitet brenda afatit ligjor, domethënë jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj përpara përfundimit të mandatit të parë.

Pas paraqitjes së kësaj kërkesë, z. Albert Murçaj iu nënshtroa dy proceseve të domosdoshme, atë të verifikimit të pasurisë dhe figurës, si dhe atë të vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e mandatit të parë. Të dyja këto procese janë zhvilluar në respektim të standardeve ligjore dhe me një nivel të lartë të përfshirjes institucionale. Veçanërisht procedura e verifikimit të pasurisë dhe figurës, e cila përfshin marrjen e të dhënave nga institucione të shumta, si: ILDKPKI, Drejtorinë e Tatimeve, Doganave, Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë e Posaçme, Agjencinë e Inteligjencës Financiare, SHISH-in dhe organe të tjera të sigurisë kombëtare, ka përfunduar me konkluzionin se kandidati nuk ka pasur asnjë cenim të integritetit të saj, asnjë përfshirje

në konflikte interesi dhe asnjë situatë që do të pengonte vazhdimin e ushtrimit të funksionit të lartë drejtues. Verifikimi përfundimtar i ILDKPKI-së është pozitiv, duke vërtetuar pastërtinë dhe transparencën e saj në deklarimin e interesave private dhe të dhënave pasurore.

Së dyti, procesi i vlerësimit etik dhe profesional përfundimisht ka rezultuar gjithashtu pozitiv. Pas një shqyrtimi të hollësishëm të praktikave dhe dokumentacionit që lidhet me ushtrimin e funksioneve të tij në periudhën 2021 – 2024, është konstatuar se z. Murçaj ka ushtruar funksionin e tij me nivel të lartë përgjegjshmërie, me përkushtim institucional dhe me respekt të plotë për parimet e drejtësisë, pa asnjë cenim të integritetit profesional apo etik. Vlerësimi përfundimtar “*Shumë mirë*” e vendos atë brenda kufirit të lartë të performancës që kërkohet nga ligji për ushtrimin e një mandati të dytë drejtues.

33. Për rrjedhojë, nga vlerësimi i të gjithë të dhënave të paraqitura, rezulton se prokurori Albert Murçaj ka përmbushur të gjitha parakushtet ligjore, procedurale dhe cilësore për t’u riemëruar në funksionin e Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

II

Në lidhje më momentin e fillimit të mandatit tre vjeçar të riemërimit të një drejtuesi

34. Procedura e riemërimit të drejtuesve dhe afatet në lidhje me të, janë përshkruar nga ligjvënësi në nenin 52, të Ligjit për Statusin, dispozitë e cila ka strukturuar në mënyrë të qartë dhe parashikon një afat të saktë për përfundimin e këtij procesi, me qëllim garantimin e vazhdimësisë institucionale, sigurimit juridik të ushtrimit të funksionit dhe mbrojtjes së parimit të pavarësisë së magjistratit në ushtrimin e funksioneve drejtuese.
35. Në thelb, siç dhe u analizua më sipër, procesi i riemërimit është i parashikuar si një procedurë e drejtpërdrejtë jo konkurruese, e rezervuar vetëm për drejtuesin aktual, me të drejtë rizgjedhjeje një herë të vetme dhe nën kushtet strikte të verifikimit të pasurisë dhe figurës dhe të një vlerësimi etik e profesional të nivelit jo më të ulët se “*Shumë mirë*”. Kjo procedurë ngrihet mbi parimin se një magjistrat që ka drejtuar më parë një institucion të drejtësisë, nuk mund të riemërohet automatikisht, por vetëm pas një kontrolli cilësor të përgjegjshëm.
36. Sipas pikës 2, të nenit 52, të Ligjit për Statusin, Drejtuesi që kërkon riemërimin ka detyrimin të paraqesë kandidaturën jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të mandatit të parë. Ky afat është thelbësor për garantimin e një periudhe të mjaftueshme, që Këshilli të ketë kohën e duhur për të kryer të gjitha veprimet verifikuese dhe vlerësuese. Pra, ky afat 6 (gjashtë) muaj është në funksion të fillimit të procesit. Megjithatë, përcaktimi i afatit për përfundimin e procesit jepet në mënyrë të qartë në pikën 5, të të njëjtit nen, ku parashikohet, se: “*Këshilli merr vendim jo më vonë se tre muaj nga mbarimi i mandatit të kryetarit.*”

37. Ky parashikim do të thotë se ligji i jep Këshillit një afat maksimal 3 (tre)-muor nga dita e përfundimit të mandatit të parë, për të përmbyllur të gjithë procedurën e riemërimit dhe për të marrë vendimin përkatës. Ky afat organizativ shërben për të mos krijuar boshllëqe në drejtimin e zyrave të prokurorive.
38. Në analizën e përgjegjësive institucionale dhe individuale, në lidhje me tejkalimin e afateve ligjore për procesin e riemërimit të z. Albert Murçaj në funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, është e domosdoshme që të evidentohet që procesi i verifikimit të pasurisë dhe figurës është një proces kompleks, i ndërlikuar dhe që ndërvaret edhe nga dërgimi i përgjigjeve apo raporteve të kontrollit dhe verifikimit nga institucionet e mësipërme. Po kështu, edhe procesi i vlerësimit etik dhe profesional lidhet me administrimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit tekniko-ligjor nga zyrat e prokurorisë për vlerësimin profesional të kandidatit. Për rrjedhojë, objektivisht, për përfundimin e procedurës për riemërimit e kandidatit Këshilli është i kushtëzuar në kohë nga përfundimi i dy proceseve të mësipërme.
39. Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet, se Këshilli gjatë periudhës përkatëse ka qenë i ngarkuar intensivisht me procese të tjera thelbësore, përfshirë vlerësimin etik dhe profesional periodik të prokurorëve në detyrë, procedurat e ngritjes në detyrë, procedurat e përzgjedhjes për vendet vakante në prokurori, si dhe shqyrtimin dhe miratimin e kandidaturave hyrëse dhe dalëse nga Shkolla e Magjistraturës. Kjo ngarkesë institucionale ka krijuar kushte të kufizuara për përfundimin në kohë të të gjitha proceseve të ndërlidhura.
40. Këshilli vlerëson, se afati tre vjeçar që duhet të gëzojë drejtuesi që ka rikandiduar dhe që është riemëruar, duhet parë i lidhur me dy elementë të rëndësishëm të statusit të magjistratëve, që janë: pavarësia e një magjistrati, si edhe zhvillimi i karrierës.
41. Për pavarësinë e prokurorëve, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë shprehet në disa dispozita. Në nenin 148, pika 2, të saj, parashikon, se: *"2. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit"*, ndërsa më tej, në nenin 149, pika 1, parashikon se: *"Këshilli i Lartë i Prokurorisë garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë"*. Në plotësim të këtyre parashikimeve, më tej, ligji themelor i vendit, në nenin 149/a, pika 1, germa "a", parashikon, se: *"1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron këto përgjegjësi: a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve;"*
42. Parashikimet kushtetuese të mësipërme, përfaqësojnë themelet juridike të konceptit të pavarësisë së këtij institucioni, si dhe të pavarësisë së prokurorëve në ushtrimin e funksioneve të tyre. Ato pohojnë, se sistemi i prokurorisë ka ndarje funksionale dhe institucionale nga pushtetet e tjera. Kjo pavarësi nuk është vetëm një status formal, por përfaqëson parakushtin themelor për funksionimin e një sistemi prokurorie që është i paanshëm, profesional dhe i besueshëm.

43. Kushtetuta shkon më tej, duke theksuar jo vetëm pavarësinë e organit të prokurorisë në tërësi, por edhe pavarësinë e brendshme të prokurorëve, duke përcaktuar që prokurori nuk është thjesht një zgjatim i hierarkisë drejtuese ose një zbatues mekanik i urdhrave të “eprorëve”, por një subjekt individualisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve hetimore dhe të ndjekjes penale, gjithmonë brenda kornizës së ligjit.

44. Nga ana tjetër, ligji themelor konfirmon, se Këshilli është institucioni garantues i kësaj pavarësie, si dhe i statusit dhe karrierës së prokurorëve. Duke qenë organ i vetëqeverisjes së sistemit të prokurorisë, Këshilli nuk ushtron kontroll të drejtpërdrejtë mbi përmbajtjen e vendimeve të prokurorëve, por krijon rregullat dhe garanton kushtet që u mundësojnë atyre të ushtrojnë funksionin në mënyrë të pavarur. Kjo përfshin procedurat për emërim, ngritje në detyrë, transferim dhe disiplinë, të cilat duhet të jenë transparente, objektive, të mbështetura në kritere meritokracie dhe të garantuara nga e drejta për mbrojtje juridike.

45. Pavarësia nuk është privilegj i prokurorit, por garanci për qytetarët që hetimi dhe ndjekja penale do të bëhen në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe të bazuar në ligj. Për këtë arsye, çdo shkelje e këtyre garancive kushtetuese, përbën jo vetëm problem ligjor, por edhe goditje ndaj besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

46. Këshilli merr në konsideratë edhe dokumente ndërkombëtare, të cilat trajtojnë statusin dhe pavarësinë e prokurorëve. Komisioni i Venecias, në studimin e tij *“Raporti mbi standardet evropiane përse i përket pavarësisë së sistemit gjyqësor: Pjesa II – Shërbimi i Prokurorisë”*, CDL-AD(2010)040, datë 3 janar 2011”, ndër të tjera shprehet se:

“18. Të gjitha këto detyra tregojnë për domosdoshmërinë që në funksionin e prokurorit të emërohen persona të përshtatshëm, me integritet të lartë dhe karakter të mirë. Cilësitë që kërkohen nga një prokuror janë të ngjashme me ato të një gjyqtari dhe kërkojnë që të jenë në fuqi procedura të përshtatshme për emërimin dhe ngritjen në detyrë. Me domosdoshmëri, një prokuror, ashtu si një gjyqtar, do të detyrohet herë pas here të marrë vendime jopopullore, të cilat mund të bëhen objekt kritikash në media dhe gjithashtu të kthehen në çështje me përmbajtje politike. Për këto arsye, është e nevojshme të garantohet një mandat i sigurt dhe rregullime të përshtatshme për ngritjen në detyrë, disiplinimin dhe shkarkimin, të cilat do të sigurojnë që një prokuror të mos mund të viktimizohet për shkak të një vendimi jopopullor që ka marrë.

...

38. Nëse do të parashikohet ndonjë mundësi për punësim të mëtejshëm (për shembull si gjyqtar) pas përfundimit të mandatit, kjo duhet të bëhet e qartë që në momentin e emërimit, në mënyrë që të shmanget çdo ide se prokurori mund të përpiqet të fitojë përkrahje nga politikanët. Nga ana tjetër, nuk duhet të ketë një ndalim të përgjithshëm për mundësinë që Prokurori i Përgjithshëm të aplikojë për funksione të tjera publike gjatë ose pas përfundimit të mandatit të tij.”

47. Më tej, edhe Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropianë, në Opinionin e tyre nr. 9, të vitit 2014, ndër të tjera ,është shprehur, se:

52. Emërimi dhe përfundimi i shërbimit të prokurorëve duhet të rregullohen me ligj në nivelin më të lartë të mundshëm dhe përmes proceseve dhe procedurave të qarta dhe të kuptueshme.

53. Afërsia dhe natyra plotësuese e misionit të gjyqtarëve dhe prokurorëve krijon kërkesa dhe garanci të ngjashme në lidhje me statusin dhe kushtet e shërbimit të tyre, konkretisht në lidhje me rekrutimin, trajnimin, zhvillimin e karrierës, pagat, disiplinën dhe transferimin (të cilat duhet të realizohen vetëm në përputhje me ligjin ose me pëlqimin e tyre). Për këto arsye, është e nevojshme të garantohet një mandat i sigurt dhe rregullime të përshtatshme për ngritjen në detyrë, disiplinën dhe shkarkimin.

48. Bazuar nga sa më sipër, rezulton qartësisht se përcaktimi i qartë dhe i saktë i datës së fillimit dhe datës së përfundimit të mandatit për drejtuesit e prokurorive që riemërohen, përbën një kërkesë themelore që lidhet drejtpërdrejt me **parimin kushtetues të pavarësisë së prokurorëve** dhe me garantimin e statusit të tyre si pjesë e pandarë e kësaj pavarësie. Ky konstatim mbështetet, jo vetëm në normën kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, por edhe në standardet ndërkombëtare të miratuara nga Komisioni i Venecias dhe Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropianë.

49. Referuar parashikimeve kushtetuese të cituara më sipër, rezulton qartësisht se Kushtetuta e ka përkufizuar prokurorinë si “organ të pavarur”, që respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve. Kjo nënkupton se prokurori, përfshirë edhe atë që ushtron funksione drejtuese, nuk është në vartësi të hierarkive politike apo administrative, por është subjekt i lirë në ushtrimin e funksioneve të tij ligjore, brenda kornizës së ligjit dhe mbi bazën e bindjes së tij profesionale. Kjo pavarësi do të ishte iluzion, nëse rrjedha e karrierës së tij do të varej nga vullneti diskrecionar i një organi tjetër, apo nëse statusi i tij në një pozicion drejtues do të mbetej i paqartë, i lëkundur, i papërcaktuar në kohë, apo i pezulluar në pritje të një vendimi të vonuar.

50. Statusi i prokurorit, siç sanksionohet në nenet 149 dhe 149/a, të Kushtetutës, përfshin jo vetëm emërimin, por edhe zhvillimin e karrierës, ngritjen në detyrë dhe ruajtjen e sigurisë së funksionit për një periudhë të përcaktuar ligjore. Pra, emërimi dhe veçanërisht riemërimi në pozicionin e Drejtuesit të një prokurorie, nuk është një akt i thjeshtë administrativ, por një element i rëndësishëm i karrierës së prokurorit, që përbën vetvetiu një zhvillim brenda statusit të tij. Për këtë arsye, përsa kohë ligji parashikon se mandati është “tre-vjeçar” dhe vetëm njëherë i rinovueshëm, çfarëdo devijimi nga ky kufizim kohor, në trajtën e zgjatjes së mandatit përtej afatit, për shkak të vonesave institucionale, do të përbente një cenim të pavarësisë funksionale dhe sigurisë së mandatit të prokurorit në detyrë.

51. Në këtë kuadër, Komisioni i Venecias, në Raportin e cituar më sipër, ka theksuar se funksioni i prokurorit kërkon, jo vetëm integritet dhe profesionalizëm, por edhe një mandat të sigurt dhe të garantuar, që e mbron atë nga çdo formë viktimizimi institucional,

për shkak të vendimeve jopopullore apo të pavarura që mund të marrë. Kjo mbrojtje procedurale është pjesë përbërëse e arkitekturës së një sistemi prokurorie që funksionon mbi bazën e ligjit dhe jo mbi vullnetin apo oportunitetin e momentit. Një mandat i pacaktuar saktësisht, që nis ose mbaron sipas nevojës së vonesave administrative, bie ndesh me këtë frymë.

52. Gjithashtu, Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropianë, në Opinionin e cituar më sipër, ka theksuar se statusi i prokurorëve, përfshirë rekrutimin, trajnimin, karrierën, disiplinën, transferimin dhe shkarkimin, duhet të rregullohet me ligj, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. Në këtë kuptim, çdo procedurë që lidhet me karrierën e tyre duhet të jetë e parashikueshme dhe transparente, duke përfshirë edhe emërimin apo riemërimin në një pozicion drejtues. Mosvendosja me saktësi e datës së fillimit dhe përfundimit të mandatit, jo vetëm që cenon sigurinë juridike të prokurorit, por lejon një hapësirë të rrezikshme për arbitraritetin institucional, duke u kthyer në një mjet potencial presioni ndaj ushtrimit të funksioneve të tij të pavarura.
53. Për rrjedhojë, duhet theksuar se parashikimi i saktë dhe i qartë i datës së fillimit dhe mbarimit të mandatit të një Drejtuesi prokurorie, i riemëruar, nuk është thjesht çështje formale e dokumentacionit administrativ, por një garanci themelore e statusit të tij si magjistrat dhe, në rrjedhojë, e pavarësisë së tij funksionale, e mbrojtur në nivel kushtetues dhe ndërkombëtar. Çdo paqartësi apo shtyrje e vendimmarrjes së Këshillit, që çon në mbivendosje të paligjshme të mandateve ose në zgjatje përtej afatit të parashikuar, nuk mund të mbrohet për shkak të pengesave procedurale apo vonesave institucionale, pasi cenon drejtpërdrejt legjitimitetin e ushtrimit të detyrës dhe minon besimin e brendshëm dhe publik në pavarësinë e sistemit të prokurorisë.
54. Gjithashtu, referuar materialeve, që rregullojnë standardet ndërkombëtare për statusin e prokurorëve, rezulton se statusi i prokurorëve duhet të barazohet në garanci dhe trajtim me atë të gjyqtarëve, për shkak të afërsisë së funksioneve që ushtrojnë dhe ndikimit që ato kanë në garantimin e sundimit të së drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të individit. Kjo kërkesë për barazi në status, nuk është vetëm një konsideratë teorike apo filozofike mbi natyrën e funksioneve publike të magjistratëve, por një parim funksional që synon të forcojë pavarësinë, profesionalizmin dhe integritetin e sistemit të drejtësisë, në tërësinë e tij.
55. Në përputhje me këto standarde, Kushtetuta, pas reformës së thellë në drejtësi të vitit 2016, ka realizuar një barazim thelbësor të statusit ndërmjet gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo është bërë e dukshme në mënyrën sesi parashikohen organet e vetëqeverisjes për secilën kategori (Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë), të cilët kanë një strukturë, funksione dhe mënyrë organizimi pothuajse të njëjtë. Kështu, Kushtetuta e përkufizon Këshillin si një organ që garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve, duke e vendosur në një trajektore të njëjtë funksionale dhe institucionale me Këshillin e Lartë Gjyqësor, i cili ka të njëjtat përgjegjësi për gjyqtarët.

56. Në këtë vijimësi, Ligji për Statusin është ndërtuar si një instrument unitar që rregullon njëkohësisht statusin e të dy kategorive të magjistratëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke përdorur të njëjtat kritere për përzgjedhje: emërim, ngritje në detyrë, transferim, vlerësim etik e profesional dhe masa disiplinore. Një element i rëndësishëm që pasqyron këtë barazi është përkufizimi i konceptit të *“ngritjes në detyrë”*, në nenin 47, i cili e përfshin njëloj emërimin si kryetar gjykate apo drejtues prokurorie, si për gjyqtarët, ashtu edhe për prokurorët. Më tej, neni 52 i këtij ligji parashikon një regjim të njëjtë për mandatin, riemërimin, kushtet dhe procedurat që duhet të përmbushë një kryetar apo drejtues, pavarësisht nëse ai ushtron funksione në gjykatë apo në prokurori.
57. Kjo mënyrë e ndërtimit të kuadrit ligjor nuk është e rastësishme, por reflekton pikërisht zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe rekomandimeve të Komisionit të Venecias dhe CCPE, sipas të cilave duhet të ketë, jo vetëm një ndarje të qartë nga pushtetet e tjera të shtetit, por edhe një trajtë të unifikuar të statusit dhe garancive të brendshme, të cilat mbështesin ushtrimin e funksioneve në mënyrë të pavarur dhe të paanshme. Në këtë kontekst, legjislatori shqiptar ka realizuar një model të përparuar që garanton barazinë e trajtimit ndërmjet gjyqtarëve dhe prokurorëve, jo vetëm në aspektin formal të statusit, por edhe në aspektin substancial të garancive profesionale dhe procedurale.
58. Për rrjedhojë, për një Drejtues prokurorie, si edhe për një Kryetar gjykate, sigurimi i një mandati të caktuar, me kufij të përcaktuar qartë në kohë (fillimi dhe përfundimi), me procedura transparente dhe objektive për riemërim dhe me garanci për mosndërhyrje apo arbitraritet institucional, nuk është një element teknik i organizimit të brendshëm, por një garanci themelore kushtetuese dhe ndërkombëtare për ushtrimin e funksionit në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me parimin e shtetit të së drejtës. Ky standard është tashmë i inkorporuar si në strukturën e ligjit themelor të vendit, ashtu edhe në legjislacionin organik për statusin e magjistratëve, duke afirmuar rolin e prokurorit si një figurë e barabartë me gjyqtarin në strukturën institucionale dhe funksionale të drejtësisë.
59. Bazuar në këtë qasje të ligjvënësit, Këshilli e sheh të nevojshme që të analizojë edhe praktikat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me statusin e magjistratëve, veçanërisht me sigurinë e afatit të mandatit të tyre. Për këtë arsye, edhe referimi në vendime që kanë të bëjnë me statusin e gjyqtarëve, në këndvështrimin e Këshillit, vlejnë edhe për prokurorët, përderisa statusi i tyre, sipas të Drejtës në fuqi, në Shqipëri është i njëjtë.
60. Në përzgjedhjen e rasteve për shqyrtim, Këshilli i drejtohet organizmave evropiane, si një model demokracie funksionale që njeh dhe respekton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Për këtë arsye, referuar praktikës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED), organi gjyqësor i Bashkimit Evropian, vend ku synojmë që të anëtarësohemi, konstatohen dy raste që kanë të bëjnë me ndërprerjen para kohe të mandatit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të gjyqtarëve të tjerë, nëpërmjet uljes së moshës së pensionit, por veçanërisht me mundësinë e zgjatjes së qëndrimit në detyrë, bazuar respektivisht, në diskrecionin e Presidentit dhe të Ministrit të Drejtësisë së Polonisë.
61. Kështu, në rastin e parë, GJED, Dhoma e Madhe, në çështjen C-618/18, *“Komisioni kundër Polonisë”*, i datës 24 qershor 2019, ndër të tjera, ka arsyetuar, se:

“111. Në këtë kuadër, fakti që një organ shtetëror, siç është Presidenti i Republikës, është ngarkuar me kompetencën për të vendosur nëse do të lejohet apo jo një zgjatje e tillë, nuk është, në vetvete, i mjaftueshëm për të konkluduar se ky parim është cenuar. Megjithatë, është e rëndësishme të sigurohet që kushtet materiale dhe rregullat procedurale përkatëse, mbi bazën e të cilave merren këto vendime, të jenë të tilla që të mos krijojnë dyshime të arsyeshme në mendjen e individëve, në lidhje me imunitetin e gjyqtarëve të prekur ndaj faktorëve të jashtëm dhe në lidhje me paanshmërinë e tyre ndaj interesave të përfshira.

...

114. Së pari, sipas këtij ligji, një zgjatje e tillë i nënshtrohet vendimit të Presidentit të Republikës, i cili është diskrecional, pasi nuk rregullohet nga ndonjë kriter objektiv dhe i verifikueshëm, dhe për të cilin nuk kërkohet dhënia e arsyeve. Për më tepër, një vendim i tillë nuk mund të ankimohej në rrugë gjyqësore.

...

118. Duke marrë në konsideratë sa më sipër, duhet konkluduar se diskrecioni që ka Presidenti i Republikës për të autorizuar – deri dy herë nga tre vjet secila – ushtrimin e funksionit gjyqësor nga një gjyqtar i Gjykatës së Lartë midis moshës 65 dhe 71 vjeç është i tillë që ngjall dyshime të arsyeshme, përfshirë në mendjen e publikut, mbi aftësinë e gjyqtarëve për të qëndruar të pa ndikuar nga faktorët e jashtëm dhe për paanshmërinë e tyre ndaj interesave të përfshira në çështjet që shqyrtojnë.”

62. Më tej, GJED, Dhoma e Madhe, në çështjen C-192/18, “Komisioni kundër Polonisë”, i datës 5 nëntor 2019, ndër të tjera, ka arsyetuar, se:

“111 Këto garanci pavarësie dhe paanshmërie kërkojnë rregulla, veçanërisht në lidhje me përbërjen e organit dhe emërimin, kohëzgjatjen e shërbimit dhe arsyet për heqje dorë, refuzim dhe shkarkim të anëtarëve të tij, të cilat duhet të jenë të tilla që të zhdukin çdo dyshim të arsyeshëm në mendjet e individëve në lidhje me paprekshmërinë e atij organi ndaj faktorëve të jashtëm dhe neutralitetin e tij në lidhje me interesat para tij (vendimet e 25 korrikut 2018, Ministri për Drejtësi dhe Barazi (Mangësi në sistemin e drejtësisë), C 216/18 PPU, EU:C:2018:586, paragrafi 66 dhe jurisprudenca e cituar, dhe të vendimit të 24 qershorit 2019, Komisioni kundër Polonisë (Pavarësia e Gjykatës Supreme), C 619/18, EU:C:2019:531, paragrafi 74).

...

113 Parimi i parevokueshmërisë kërkon, në veçanti, që gjyqtarët të mund të qëndrojnë në detyrë me kusht që të mos kenë arritur moshën e detyrueshme të daljes në pension ose deri në mbarimin e mandatit të tyre, kur ky mandat është për një afat të caktuar. Megjithatë nuk është tërësisht absolut, nuk mund të ketë përjashtime nga ky parim, përveç nëse ato justifikohen nga arsye legjitime dhe bindëse, në varësi të parimit të

proporcionalitetit. Kështu, pranohet gjerësisht se gjyqtarët mund të shkarkohen nëse konsiderohen të papërshtatshëm për qëllimet e kryerjes së detyrave të tyre për shkak të paafësisë ose një shkeljeje serioze të detyrimeve të tyre, me kusht që të ndiqen procedurat e duhura (vendimi i 24 qershorit 2019, Komisioni kundër Polonisë (Pavarësia e Gjykatës Supreme), C 619/18, EU:C:2019:531, paragrafi 76).

116 Në rastin aktual, siç u shpjegua si në seancën dëgjimore ashtu edhe në pretendimet e tij me shkrim, me ankesën e tij të dytë Komisioni nuk kërkon të kritikojë masën që ul moshën e daljes në pension të gjyqtarëve të gjykatave të zakonshme polake në vetvete. Kjo ankesë në thelb drejtohet ndaj mekanizmit me të cilin u shoqërua ajo masë, sipas të cilit Ministri i Drejtësisë ka të drejtë të autorizojë gjyqtarët e këtyre gjykatave që të vazhdojnë në mënyrë aktive të kryejnë detyra gjyqësore përtej moshës së pensionit, siç është ulur. Sipas parashtrimit të Komisionit, në dritën e karakteristikave të tij, ky mekanizëm minon pavarësinë e gjyqtarëve në fjalë, në atë masë që nuk i mundëson atyre të garantohet se ata do të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë tërësisht autonome dhe do të mbrohen nga ndërhyrjet ose presionet e jashtme. Për më tepër, kombinimi i masës dhe mekanizmit minon parevokueshmërinë e tyre.

117 Në këtë drejtim, duhet theksuar, si pikë paraprake, se mekanizmi i kritikuar nga Komisioni nuk merret me procesin e emërimit të kandidatëve për të kryer detyra gjyqësore, por me mundësinë që gjyqtarët në detyrë, të cilët gëzojnë garancitë e natyrshme në kryerjen e këtyre detyrave, të vazhdojnë t'i kryejnë ato përtej moshës normale të daljes në pension, dhe se ky mekanizëm në përputhje me rrethanat ka të bëjë me kushtet në të cilat karriera e tyre përparon dhe përfundon (shih, me analogji, vendimin e 24 qershorit 2019, Komisioni kundër Polonisë (Pavarësia e Gjykatës Supreme), C 619/18, EU:C:2019:531, paragrafi 109).

118 Për më tepër, megjithëse u takon vetëm Shteteve Anëtare të vendosin nëse do ta autorizojnë apo jo një zgjatje të tillë të periudhës së veprimtarisë gjyqësore përtej moshës normale të daljes në pension, fakti mbetet se, kur këto Shtete Anëtare zgjedhin të miratojnë një mekanizëm të tillë, ato duhet të sigurohen që kushtet dhe procedura të cilave u nënshtrohet një zgjatje e tillë nuk janë të tilla që të minojnë parimin e pavarësisë gjyqësore (vendimi i 24 qershorit 2019, Komisioni kundër Polonisë (Pavarësia e Gjykatës Supreme), C 619/18, EU:C:2019:531, paragrafi 110).

119 Lidhur me nevojën, të vënë në dukje në paragrafët 109 deri në 111 të këtij vendimi, për të siguruar që gjykatat të mund të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë tërësisht autonome, objektive dhe pa asnjë interes në rezultatin e proceseve, ndërkohë që mbrohen nga ndërhyrjet ose presionet e jashtme që mund të dëmtojnë gjykimin e pavarur të anëtarëve të tyre dhe të ndikojnë në vendimet e tyre, është e vërtetë, se fakti që një organi, siç është Ministri i Drejtësisë, i është besuar kompetenca për të vendosur nëse do të japë apo jo ndonjë zgjatje të periudhës së aktivitetit gjyqësor përtej

moshës normale të daljes në pension nuk është i mjaftueshëm në vetvete për të arritur në përfundimin se parimi i pavarësisë gjyqësore është cënuar. Megjithatë, është e nevojshme të sigurohet që kushtet thelbësore dhe rregullat e hollësishme procedurale që rregullojnë miratimin e vendimeve të tilla, të jenë të asaj natyre që nuk mund të krijojnë dyshime të arsyeshme, në mendjet e individëve, në lidhje me paprekshmërinë e gjyqtarëve përkatës ndaj faktorëve të jashtëm dhe në lidhje me neutralitetin e tyre përballë interesave që kanë para tyre (shih, për analogji, vendimin e 24 qershorit 2019, Komisioni kundër Polonisë (Pavarësia e Gjykatës Supreme), C 619/18, EU:C:2019:531, paragrafi 111).

120 Për këtë qëllim, është e nevojshme, në veçanti, që këto kushte dhe rregulla procedurale të hartohen në një mënyrë të tillë që këta gjyqtarë të mbrohen nga tundimet e mundshme për t'u dorëzuar ndaj ndërhyrjeve ose presioneve të jashtme që mund të rrezikojnë pavarësinë e tyre. Prandaj, rregulla të tilla procedurale duhet të jenë të tilla që të përjashtojnë jo vetëm çdo ndikim të drejtpërdrejtë, në formën e udhëzimeve, por edhe llojet e ndikimit që janë më të tërthorta dhe që mund të kenë një efekt në vendimet e gjyqtarëve përkatës (vendimi i 24 qershorit 2019, Komisioni kundër Polonisë (Pavarësia e Gjykatës Supreme), C 619/18, EU:C:2019:531, paragrafi 112 dhe jurisprudenca e cituar).

121 Në rastin konkret, kushtet dhe rregullat e hollësishme procedurale që dispozitat kombëtare të kontestuara vendosin në lidhje me mundësinë që gjyqtarët e gjykatave të zakonshme polake të vazhdojnë të kryejnë detyrat e tyre përtej moshës së re të daljes në pension nuk i plotësojnë këto kërkesa. 122 Para së gjithash, Neni 69(1b) i Ligjit për gjykatat e zakonshme parashikon që Ministri i Drejtësisë mund të vendosë nëse do të autorizojë apo jo një vazhdim të tillë në bazë të kriterëve të caktuar. Megjithatë, këto kritere janë shumë të paqarta dhe të paverifikueshme dhe, për më tepër, siç pranoi Republika e Polonisë në seancën dëgjimore, vendimi i ministrit nuk kërkohet të japë arsye, ndër të tjera duke iu referuar këtyre kriterëve. As një vendim i tillë nuk mund të kundërshtohet në procedurat gjyqësore (shih, në këtë kuptim, vendimin e 24 qershorit 2019, Komisioni kundër Polonisë (Pavarësia e Gjykatës Supreme), C 619/18, EU:C:2019:531, paragrafi 114).

123 Më pas, sipas Nenit 69(1) të Ligjit për gjykatat e zakonshme, kërkesa për zgjatjen e periudhës për të cilën kryhen detyrat gjyqësore duhet të bëhet nga gjyqtarët përkatës jo më herët se 12 muaj dhe jo më vonë se 6 muaj para arritjes së moshës normale të daljes në pension. Për më tepër, siç pohon Komisioni në parashtrimet e tij me shkrim dhe në seancën dëgjimore pa u kundërshtuar nga Republika e Polonisë, kjo dispozitë nuk përcakton një afat brenda të cilit Ministri i Drejtësisë duhet të marrë vendimin e tij në këtë drejtim. Kjo dispozitë, në lidhje me Nenin 69(1b) të Ligjit për gjykatat e zakonshme i cili parashikon që, kur një gjyqtar arrin moshën normale të daljes në pension para se të përfundojë procedura për zgjatjen e periudhës së detyrave gjyqësore, personi në fjalë duhet të mbetet

në detyrë derisa të përfundojë kjo procedurë, është e tillë që të zgjasë periudhën e pasigurisë për gjyqtarin në fjalë. Nga sa më sipër rrjedh se kohëzgjatja e periudhës për të cilën gjyqtarët janë të detyruar të vazhdojnë të presin vendimin e Ministrit të Drejtësisë pasi të jetë kërkuar zgjatja, gjithashtu, në fund të fundit bie nën diskrecionin e ministrit.

124 Duke pasur parasysh sa më sipër, duhet të konstatohet se fuqia që mban në këtë rast Ministri i Drejtësisë me qëllim që të vendosë nëse do të autorizojë apo jo gjyqtarët e gjykatave të zakonshme polake që të vazhdojnë të kryejnë detyrat e tyre, nga moshë 60 deri në 70 vjeç në rastin e grave dhe nga moshë 65 deri në 70 vjeç në rastin e burrave, është e tillë që të ngjallë dyshime të arsyeshme, ndër të tjera në mendjet e individëve, në lidhje me paprekshmërinë e gjyqtarëve në fjalë ndaj faktorëve të jashtëm dhe në lidhje me neutralitetin e tyre përsa i përket interesave që mund të jenë objekt i shqyrtimeve para tyre (shih, me analogji, vendimin e 24 qershorit 2019, Komisioni kundër Polonisë (Pavarësia e Gjykatës Supreme), C 619/18, EU:C:2019:531, paragrafi 118).

125 Për më tepër, kjo kompetencë nuk përputhet me parimin e parevokueshmërisë, i cili është i natyrshëm për pavarësinë gjyqësore (vendimi i 24 qershorit 2019, Komisioni kundër Polonisë (Pavarësia e Gjykatës Supreme), C 619/18, EU:C:2019:531, paragrafi 96).

126 Në këtë drejtim, duhet analizuar kjo kompetencë që iu dha Ministrit të Drejtësisë në kontekstin më të përgjithshëm të një reforme që rezultoi në uljen e moshës normale të daljes në pension, ndër të tjera, të gjyqtarëve të gjykatave të zakonshme polake.

127 Së pari, duke pasur parasysh, në veçanti, disa dokumente përgatitore që lidhen me reformën në fjalë, kombinimi i dy masave të përmendura në paragrafin e mëparshëm është i tillë që të krijojë, në mendjet e individëve, dyshime të arsyeshme në lidhje me faktin se sistemi i ri mund të ketë pasur për qëllim t'i mundësojë Ministrit të Drejtësisë, duke vepruar sipas gjykimit të tij, të shkarkojë, sapo të arrihet moshë normale e daljes në pension e vendosur rishtazi, grupe të caktuara gjyqtarësh që shërbejnë në gjykatat e zakonshme polake, duke mbajtur të tjerë prej këtyre gjyqtarëve në detyrë (shih, për analogji, vendimin e 24 qershorit 2019, Komisioni kundër Polonisë (Pavarësia e Gjykatës Supreme), C 619/18, EU:C:2019:531, paragrafi 85).

128 Së dyti, duhet theksuar se periudha për të cilën gjyqtarët e gjykatave të zakonshme polake kryejnë detyra gjyqësore, e cila kështu bie nën diskrecionin e pastër të Ministrit të Drejtësisë, është e konsiderueshme pasi ajo arrin në 10 vitet e fundit të kryerjes së detyrave të tilla në karrierën e një gjyqtareje femër dhe 5 vitet e fundit të kryerjes së tyre në karrierën e një gjyqtari mashkull.

129 Së treti, duhet të kujtojmë se, sipas Nenit 69(1b) të Ligjit për gjykatat e zakonshme, kur një gjyqtar arrin moshën normale të daljes në pension para se të përfundojë procedura për zgjatjen e periudhës së detyrave gjyqësore, ai ose ajo duhet të mbetet në detyrë derisa kjo procedurë të përfundojë. Në një situatë të tillë, çdo vendim negativ i Ministrit të

Drejtësisë - i cili për më tepër, siç është vënë re tashmë në paragrafin 123 të këtij vendimi, nuk i nënshtrohet asnjë afati kohor - miratohet pasi gjyqtari në fjalë të jetë mbajtur në detyrë, sipas rastit për një periudhë relativisht të gjatë pasigurie, përtej moshës normale të daljes në pension. 130 Në dritën e konsideratave të përcaktuara në paragrafët 126 deri në 129 të këtij vendimi, duhet të konstatohet se, meqenëse kërkesat e përmendura në paragrafët 113 deri në 115 të këtij vendimi nuk janë përmbushur, kombinimi i masës që ul moshën normale të daljes në pension në 60 vjeç për gratë dhe 65 vjeç për burrat dhe i diskrecionit që i është dhënë në rastin konkret Ministrit të Drejtësisë me qëllim dhënien ose refuzimin e autorizimit për gjyqtarët e gjykatave të zakonshme polake për të vazhduar të kryejnë detyrat e tyre, nga mosha 60 deri në 70 vjeç në rastin e grave dhe 65 deri në 70 vjeç në rastin e burrave, nuk përputhet me parimin e parevokueshmërisë.”

63. Referuar praktikës shqiptare, Këshilli konstaton se Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë në Vendimin nr. 84 datë 23.12.2024, ndër të tjera, ka arsyetuar, se:

“28. ... Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar, se me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është “i pavarur”, ndër të tjera, duhet konsideruar mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre. Garancia e kohëzgjatjes dhe paprekshmërisë së mandatit e mbrojnë gjyqtarin nga ndikimet e forcave politike që mund të vijnë në pushtet. Vetëm një gjykatë e pavarur, së cilës i garantohet paprekshmëria e mandatit të anëtarëve të saj, mund të konsiderohet si një gjykatë që administron drejtësinë kushtetuese, në përputhje me parimet kushtetuese. Edhe pse mandati i gjyqtarit kushtetues ka kuptimin e një mandati të dhënë (jo të fituar nëpërmjet votës së zgjedhësve aktivë), parimi i pavarësisë nënkupton, gjithashtu, se gjyqtari, në momentin e emërimit, duhet të dijë kohëzgjatjen e këtij mandati, bazuar në rregullimet ligjore përkatëse dhe kjo kohëzgjatje nuk mund të lihet në diskrecion të organeve që e kanë emëruar/zgjedhur atë.”

...
33. Në vijim të kësaj analize duket se me shtimin e këtij togfjalëshi në përmbajtje të dispozitës kalimtare, kushtetutë-bërësi në ekuilibrin midis parimit të qëndrueshmërisë në detyrë dhe atij të përtëritjes së Gjykatës, i ka kushtuar vëmendje të veçantë këtij të fundit. Nga ana tjetër, për sa i takon datës së përfundimit të mandatit, edhe pse neni 129 i Kushtetutës i lidhur me nenin 8, pika 3, të Ligjit nr. 8577/2000 referon te momenti i betimit, në rastin konkret, data dhe muaji i mbarimit të mandatit të gjyqtarës H.Z. nuk mund të lidhet me datën e betimit të saj (25 janar). Një interpretim i tillë do të binte ndesh me parimin e pavarësisë, në kuptim të sigurisë juridike, sipas të cilit gjyqtari kushtetues, në momentin e emërimit, duhet të dijë kohëzgjatjen e këtij mandati (shih paragrafin 28 të vendimit), pasi aktet që lidhen me procedurën e ndjekur nga Gjykata e Lartë për emërimin e saj i janë referuar muajit mars të vitit 2025.”

64. Bazuar në rastet e mësipërme, standardi ndërkombëtar mbi garancinë e mandatit të magistratit, i zhvilluar veçanërisht nga GJED dhe Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, është i qartë dhe njëtrajtshëm i konsoliduar, nga ku rezulton se siguria dhe parashikueshmëria e mandatit përbëjnë një prej shtyllave më themelore të parimit të pavarësisë së gjyqtarit apo prokurorit. Ky standard nuk e konsideron pavarësinë si një atribut abstrakt apo etik, por si një mekanizëm funksional që garanton ushtrimin efektiv dhe të pandikuar të funksioneve të drejtësisë. Në këtë kuadër, siguria e mandatit, e shprehur përmes përcaktimit të qartë të datës së fillimit dhe përfundimit të tij, nuk është vetëm një kërkesë procedurale, por një garanci substanciale e statusit të magistratit.
65. GJED, në çështjet C-619/18 dhe C-192/18 kundër Polonisë, ka zhvilluar një doktrinë të qëndrueshme mbi këtë çështje. Në të dy rastet, GJED vlerësoi se, edhe pse legjislacioni polak i njihte Presidentit të Republikës ose Ministrit të Drejtësisë kompetencën për të zgatur mandatin e gjyqtarëve përtej moshës normale të pensionit, vetë fakti që kjo kompetencë ishte diskrecionare, pa kriteret e qarta dhe objektive, pa arsyetim të detyruar dhe pa mundësi për t'u ankumuar, krijonte një rrezik të qartë që gjyqtarët të ndiheshin të varur nga vullneti i një autoriteti ekzekutiv, qasje kjo që cenonte në mënyrë të drejtpërdrejtë pavarësinë e tyre. Në mënyrë të veçantë, GJED nënvizoi se një mandat që vazhdon me vendim të autoritetit ekzekutiv, pa garanci për kohëzgjatje të përcaktuar, pa mundësi kontrolli dhe pa bazë të verifikueshme, nuk përputhet me parimin e parevokueshmërisë, që është thelbësor për pavarësinë e gjyqtarëve.
66. Ajo që thekson GJED është, se jo vetëm autoriteti ekzekutiv nuk duhet të ketë kompetencë diskrecionare për zgjatjen e mandatit, por edhe kur ligji i jep këtë kompetencë, ajo duhet të ushtrohet sipas kushteve të ngurta dhe të verifikueshme, në mënyrë që të mos lindin dyshime për neutralitetin dhe imunitetin e gjyqtarit ndaj ndikimeve të jashtme. Në këtë drejtim, vetë ekzistenca e një mekanizmi që lejon zgjatjen e mandatit nga një organ tjetër, në mënyrë të pakufizuar ose të paqartë, përbën një cenim të pavarësisë institucionale.
67. Në të njëjtën frymë, edhe Gjykata Kushtetuese ka konfirmuar se paprekshmëria e mandatit të gjyqtarit përbën një element thelbësor të pavarësisë. Sipas saj, gjyqtari, në momentin e emërimit, duhet të dijë saktësisht kohëzgjatjen e mandatit të tij. Kjo nënkupton, jo vetëm njohjen e kohës kur nis dhe përfundon mandati, por edhe pamundësinë për ta shtyrë atë përtej afatit të ligjshëm, në mungesë të një dispozite të posaçme që e autorizon këtë veprim. Ky parim është vendosur si një standard themelor, i cili në vetvete është një mbrojtje ndaj çdo tentative për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes së gjyqtarit apo prokurorit, qoftë edhe në mënyrë të tërthortë, përmes pasigurisë së statusit.
68. Nëse këto standarde ndërkombëtare i ballafaqojmë me ligjin shqiptar, më konkretisht me Ligjin për Statusin, konstatojmë një ndryshim thelbësor në favor të një mbrojtjeje më të fortë të pavarësisë. Ligji në fjalë, në nenin 52, të tij, nuk i njeh aspak Këshillit kompetencën për të zgatur mandatin e drejtuesve të prokurorive, në rast se procesi i riemërimit nuk është përfunduar në kohë. Mungesa e këtij parashikimi është

domethënëse, pasi tregon se ligjvënësi ka vendosur vetëdijshëm të mos i japë një kompetencë të tillë Këshillit, as për të zgatur mandatin, as për të pezulluar riformulimin e tij për arsye praktike apo vonesash procedurale. Për rrjedhojë, çdo vendimmarrje e Këshillit që do të shtonte artificialisht mandatin e Drejtuesit të një zyre prokurorie, do të sillte si pasojë krijimin e normave ligjore nga ky institucion, duke tejkaluar në këtë formë, kompetencat e tij kushtetuese, si edhe duke cenuar parimin dhe ndarjen e pushteteve.

69. Për më tepër, një qasje e tillë e Këshillit do të cenonte edhe rregullat e interpretimit (*Canons of interpretations*) dhe konkretisht “Rregullin e mosplotësimit të normave” (*Omitted-Case Canon*) ku, sipas këtij rregulli, ndalon çdo institucion që të shtojë ose të interpretojë çështje që janë lënë jashtë, në mënyrë të qartë, nga teksti ligjor. Ky parim, i shprehur me frazën latine “*casus omissus pro omissio habendus est*” që përkthehet si “*rasti i lënë i parregulluar nga legjislatori duhet të konsiderohet i parregulluar*” dhe kërkon që institucionet të përmbahen nga ndërhyrjet apo “zbukurimet” në ligj, për të mbuluar boshllëqet që mund të ekzistojnë. Rregulli përjashton interpretimin krijues dhe e konsideron detyrën e çdo institucioni të kufizuar vetëm te zbatimi i asaj që është qartësisht përfshirë në tekstin ligjor, duke shmangur, qëllimisht, supozimet mbi atë që ligjvënësi “do të kishte dashur” të ishte në normat që ka miratuar.
70. Qasja tradicionale ndaj këtij rregulli është se institucionet nuk mund të krijojnë ose të plotësojnë boshllëqet që ekzistojnë në ligj. Ky parim nuk e konsideron të arsyeshme që gjykata të “supozojë” atë që ligjvënësi mund të kishte synuar në një rast të caktuar, por të respektojë kufijtë e dhënë në tekstin ligjor, edhe kur ligji duket se ka lënë hapësira të paplotësuara.
71. Zbatimi i këtij rregulli është veçanërisht i rëndësishëm për të ruajtur integritetin e ndarjes së pushteteve dhe për të respektuar qartësinë e synuar nga ligjvënësi. Ky rregull interpretimi shmang devijimet dhe interpretimet subjektive, të cilat mund të ndikojnë në qartësinë juridike dhe të minojnë besimin e shtetasve në sistemin e drejtësisë. Një ndërhyrje krijuese nga institucionet e ndryshme për të plotësuar boshllëqe që ligjvënësi nuk i ka adresuar vetë, mund të krijojë precedentë të rrezikshëm, ku institucionet luajnë një rol ligjvënës, duke cenuar kështu parimin e demokracisë dhe duke sfiduar sovranitetin e pushtetit legjislativ.
72. Duke vijuar më tej me arsyetimin, rezulton se ndryshe nga rastet e analizuar nga GJED, ku megjithëse ekzistonin disa kritere për veprimin e Presidentit ose Ministrit të Drejtësisë, përsëri u konsiderua shkelje e parimit të pavarësisë, në rastin e Shqipërisë, Ligji për Statusin nuk parashikon asnjë kriter që mund të justifikojë një vendim të Këshillit për të zgatur praktikisht mandatin e një Drejtuesi, duke e riemëruar atë. Kjo do të thotë, se çdo shtyrje e qëndrimit në detyrë, përtej periudhës 3 (tre) - vjeçare të ligjshme, për shkak të vonesës në procedurat e riemërimit, përbën një veprim pa mbështetje ligjore dhe, rrjedhimisht, një cenim të parimit të pavarësisë së magjistratit, në formën e pasigurisë juridike dhe ndërprerjes së njëtrajtshme të zhvillimit të karrierës.
73. Në këtë këndvështrim, riemërimi i Drejtuesit, në këtë rast, nuk mund të konsiderohet se ka krijuar një mandat të ri, që fillon në datën e vendimit të riemërimit. Përkundrazi, duke

qenë se Ligji parashikon që *Këshilli duhet të vendosë jo më vonë se 3 (tre) muaj para mbarimit të mandatit*, dhe duke qenë se ligji nuk autorizon që Drejtuesi të qëndrojë në detyrë përtej mandatit të parë, pa u riemëruar brenda afatit, është e domosdoshme që mandati i dytë të konsiderohet si një vijim i atij të mëparshëm, që ka nisur nga momenti kur ligjërisht duhej të fillonte, pra, nga dita pas përfundimit të mandatit të parë.

74. Ky interpretim është i vetmi që harmonizon dispozitat e ligjit shqiptar me standardet ndërkombëtare të pavarësisë dhe sigurisë së mandatit, si dhe me jurisprudencën e GJED dhe të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë. Çdo interpretim tjetër do të çonte, në fakt, në një shtyrje të paarsyeshme dhe të paautorizuar të mandatit, përmes një vakumi institucional, që ligji nuk e njeh dhe që mund të shfrytëzohet për të ndikuar në mënyrë të tërthortë në statusin e drejtuesit dhe në përmbajtjen e funksionit të tij drejtues. Prandaj, vetëm duke konsideruar mandatin e dytë si të filluar që në përfundim të mandatit të parë, mund të garantohej një përputhje e plotë me Kushtetutën, me ligjin organik dhe me detyrimet që rrjedhin nga standardet ndërkombëtare për garantimin e pavarësisë së prokurorit.
75. Për më tepër, Këshilli vë në dukje, se *mandati i Drejtuesit të prokurorisë, i cili është riemëruar pas përfundimit të mandatit të tij të parë, duhet të konsiderohet si i ushtruar pa ndërprerje*, për shkak se ai ka vazhduar faktikisht ushtrimin e detyrës nëpërmjet një *caktimi të përkohshëm*, nga vetë Këshilli. Kjo mënyrë e të vepruarit mbështetet jo vetëm në ligjshmërinë e situatës faktike, por edhe në një qasje të harmonizuar me parimin e sigurisë juridike, me standardet ndërkombëtare dhe me normat përkatëse të së drejtës së brendshme.
76. Në radhë të parë, është e rëndësishme të theksohet se ushtrimi i funksionit në mënyrë të pandërprerë nga ana e Drejtuesit, e përjashton çdo konstatim të faktit se kemi të bëjmë me një boshllëk funksional apo me një ndërprerje të statusit të tij. Edhe pse formalizimi i riemërimit ka ndodhur me vonesë, në mënyrë faktike, detyra është ushtruar pandërprerë, me *caktim të përkohshëm* nga Këshilli, i cili është organi kompetent për të garantuar funksionimin e strukturës dhe për të siguruar vazhdimësinë institucionale. Kjo zgjidhje, e ndjekur nga Këshilli, është mbështetur në një logjikë praktike dhe të arsyeshme të mbrojtjes së funksionalitetit të institucionit, si edhe të ruajtjes së vazhdimësisë së veprimtarisë së zyrës së prokurorisë.
77. Duke pasur parasysh se Drejtuesi nuk është larguar asnjë ditë nga ushtrimi i funksionit, nuk mund të pretendohet se kemi të bëjmë me një *"fillim të ri"* mandati, në kuptimin që e kërkon Ligji për Statusin. Në të kundërt, kemi një vijimësi organike të ushtrimit të funksionit, e cila kërkon një trajtim të unifikuar, edhe në aspektin formal.
78. Siç është analizuar më sipër, Ligji për Statusin nuk ndalon në asnjë dispozitë të tij mundësinë që një vendim për riemërim të ketë efekt nga një datë e mëhershme, për aq kohë sa është brenda kuadrit të përgjegjësisë të Këshillit. Përkundrazi, ligji vendos si afat objektiv 3 (tre) muaj përpara përfundimit të mandatit për vendimmarrjen e Këshillit mbi çështjen e riemërimit, por nuk sanksionon pasoja të pavlefshmërisë, në rast të tejkalimit të këtij afati. Vetëm mënyra si është formuluar neni 52, i këtij Ligji, i jep Këshillit një

hapësirë të ligjshme për ta përkufizuar datën e fillimit të mandatit të riemëruar, si momentin kur ai duhej të kishte nisur sipas ligjit, pra, menjëherë pas përfundimit të mandatit të parë.

79. Gjithashtu, kjo zgjidhje e tillë është qartësisht në favor të palës së interesuar, pra Drejtuesit të prokurorisë, duke qenë se ai nuk është shkëputur kurrë nga funksioni i tij, nuk i është njoftuar ndonjë vendim për përfundim të ushtrimit të detyrës, si dhe ka vazhduar të ushtrojë kompetencat e plota të funksionit Drejtues në mënyrë të pandërprerë. Si rrjedhojë, çdo interpretim që do të konsideronte se mandati i tij i dytë fillon në një datë të mëvonshme nga ai kur përfundoi mandati i parë, në fakt do të krijonte një pasiguri të paarsyeshme dhe të padrejtë në statusin e tij.
80. Për më tepër, nga kjo situatë nuk rezulton asnjë dëm ndaj ndonjë pale të tretë. Nuk ka persona të tjerë, që pretendojnë të kenë pasur të drejtë ligjore mbi pozicionin në fjalë, gjatë periudhës së ndërmjetme, as ndonjë interes të cenuar që mund të shërbejë si pengesë për këtë lloj vendimmarrje nga ana e Këshillit.
81. Përsa i përket pritshmërisë që vetë Drejtuesi ka pasur, ajo del qartë nga kërkesa që ka paraqitur pranë Këshillit, ku kërkon riemërimin e tij sipas legjislacionit në fuqi. Nuk mund të imagjinohet dhe, prej tij nuk është shprehur asnjëherë, që nga ana e tij ka pasur pritshmëri që mandati i tij si Drejtues do të shtyhej në kohë, jashtë afatit ligjor.
82. Në këtë kuptim, data e fillimit të mandatit të dytë duhet të konsiderohet si data e përfundimit të mandatit të parë, pasi vetëm kjo përputhet me ushtrimin faktik të funksionit, me frymën e ligjit dhe me standardet e pavarësisë të njohura si në të drejtën e brendshme, ashtu edhe në të drejtën evropiane. Çdo zgjidhje tjetër, do të minonte integritetin e sistemit të karrierës dhe do të krijonte precedentë të rrezikshëm për pasiguri, në ushtrimin e funksioneve të larta në sistemin e drejtësisë.
83. Arsyetimi i mësipërm, e sheh pozicionin e Kryetarit/Drejtuesit të prokurorisë, si pjesë e statusit të prokurorit, kur ai realizon një nga mënyrat e parashikuara nga ligji për ngritjen në detyrë. Por, edhe nëse e shohim pozicionin e Kryetarit/Drejtuesit të prokurorisë, nga pikëpamja e së drejtës administrative, përsëri nuk rezulton mundësia e zgjatjes së afatit të qëndrimit në detyrë për këto pozicione.
84. Kështu përveç, legjislacionit sektorial, që siç u analizua më sipër, nuk e parashikon këtë mundësi, edhe legjislacioni që rregullon të drejtën administrative në Shqipëri, nuk e ka një parashikim të tillë.
85. Këshilli vëren, se jurisprudenca e krahasuar shprehet që, edhe në të drejtën administrative, mundësia e zgjatjes së mandatit, duket të rrjedhë nga një parashikim i qartë ligjor, siç rezulton edhe nga Vendimi nr. 208, datë 14 prill – 4 maj 1992, i Gjykatës Kushtetuese të Italisë, e cila ndër të tjera ka arsyetuar, se:

“4.2 – ... Në këtë drejtim, Gjykata vëren, se, ndryshe nga sa shpeshherë mendohet nga një opinion i përsëritur në mënyrë të paarsyeshme, nga

kompleksi normativ në fuqi nuk është e mundur të nxirret përfundimi se ajo që quhet “prorogatio de facto”, me kohëzgjatje të pasigurt, përbën një rregull të përgjithshëm dhe të vlefshëm për organet administrative.

...

86. 4.5 – Sa u përket më tej normave, të cilat ndonjëherë përmenden për të mbështetur karakterin e përgjithshëm të këtij parimi dhe që parashikojnë shprehimisht për zgjatjen e mandatit të organeve kushtetuese ose me rëndësi kushtetuese — për ta lejuar, kufizuar ose përjashtuar — as prej tyre nuk mund të nxirren argumente të vlefshme për organet administrative. Kjo, sepse parashikimet përkatëse janë në të gjitha rastet të veçuara dhe të ndryshme, pra jo treguese të një rregulli të unifikuar, si dhe për faktin se organizimi administrativ nuk rregullohet në bazë të normave që përkasin organeve kushtetuese, por mbi bazën e parimeve të përcaktuara nga neni 97 i Kushtetutës. Sipas këtyre parimeve — siç do të sqarohet më tej — rregulli i prorogatio pa afat të caktuar, nëse do të konsiderohej në fuqi, do të rezultonte në kundërshtim me Kushtetutën.

4.6 – Është, për pasojë, pa themel dallimi që herë pas here është bërë midis “prorogatio”, si rezultat i një parashikimi të shprehur ligjor, dhe prorogatio (de facto) si një situatë e lidhur automatikisht me një vakancë të pazakontë. Në fakt, duke qenë se, sipas përfundimeve të arritura më sipër, duhet përjashtuar ekzistenca e normave nga të cilat mund të nxirret parimi i përgjithshëm i prorogatio, duhet pranuar se çdo zgjatje mandati, në përputhje me parimet që rrjedhin nga neni 97 i Kushtetutës, mund të ekzistojë vetëm nëse është parashikuar shprehimisht me ligj dhe vetëm brenda kufijve të përcaktuar nga ky ligj. Për pasojë, dallimi humbet çdo vlerë të rëndësishme.

As tezës, sipas së cilës rregulli i prorogatio de facto, me kohëzgjatje të pacaktuar, duhet konsideruar si në fuqi, për shkak se është i lidhur në mënyrë të pandashme me vetë thelbin e sistemeve juridike dhe si rrjedhim ka zbatim automatik dhe të përgjithshëm, nuk mund t’i jepet mbështetje me argumente të qëndrueshme. Përkundrazi, nëse ky rregull do të kishte vlerë të përgjithshme dhe nuk do të shoqërohej me masa mbrojtëse që të parandalojnë abuzimin — të ngjashme me ato që janë të pranishme në sistemet për rinovimin e organeve të zgjedhura të njëjësive vendore — atëherë do të lindte një përplasje me Kushtetutën pikërisht për këtë rregull. Një organizim që karakterizohet nga përdorimi i zakonshëm i prorogatio do të ishte, në fakt, larg modelit kushtetues. Nëse është parashikuar me ligj që organet administrative të kenë një kohëzgjatje të caktuar dhe, për rrjedhojë, kompetencat e tyre të jenë të kufizuara në kohë, një prorogatio de facto sine die — që ia lë në dorë arbitraritetit të atij që duhet të ndër marrë zëvendësimin për të përcaktuar kohëzgjatjen që ligjvënësi e ka përcaktuar si të kufizuar — do të shkelte parimin e rezervës ligjore në çështje të organizimit administrativ, si edhe parimet e paanshmërisë dhe të funksionimit të mirë të administratës publike.”

87. Në përfundim të të gjithë arsyetimit të zhvilluar më sipër, rezulton qartësisht se, edhe nëse pozicioni i Drejtuesit të prokurorisë shihet nga një këndvështrim i thjeshtë i së drejtës administrative, përtej natyrës së tij si pjesë integrale e statusit të magjistratit dhe si një formë e ngritjes në detyrë, sipas Ligjit për Statusin, përsëri nuk është e mundur të pranohet zgjatja e mandatit të këtij pozicioni përtej kufirit 3 (tre) vjeçar të përcaktuar nga ligji. Kjo, për shkak se vetë parimet e së drejtës administrative nuk e tolerojnë ekzistencën e një mandati të zgjatur në mënyrë të pashprehur nga ligji, qoftë edhe në mënyrë të përkohshme, në mungesë të një dispozite të qartë që ta parashikojë një gjë të tillë.

87. Jurisprudenca e cituar më sipër, thekson në mënyrë të qartë se çdo lloj zgjatjeje mandati duhet të ketë një bazë të qartë, eksplicite dhe të kufizuar ligjore. Në të kundërt, çdo zgjatje mandati që lind automatikisht për shkak të vakancës ose nevojës, pa u parashikuar në ligj, përbën një cenim të rendit kushtetues dhe krijon një rrezik real të arbitraritetit, nëse zëvendësimi apo riemërimi funksionarit që ka përfunduar mandatin mbetet në dorë të vullnetit apo neglizhencës së një autoriteti tjetër.

88. Në mënyrë të natyrshme, këto standarde janë të zbatueshme, edhe në kontekstin shqiptar, për vetë faktin se sistemi juridik vendas, njeh po ashtu parimin e ligjshmërisë në administratën publike, sipas nenit 4, të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 3, të Ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” (si analogji në këtë rast). Më tej, mungesa e një dispozite të shprehur në Ligjin për Statusin, që t’i japë Këshillit kompetencën për të zgjatur mandatin e drejtuesve përtej afatit ligjor, përbën një mospërputhje të drejtpërdrejtë me këto standarde, duke sjellë një cenim të sigurisë juridike dhe të vetë garancive për ushtrimin e funksioneve publike në mënyrë të pavarur dhe të parashikueshme.

89. Prandaj, qëndrimi që justifikon zgjatjen e mandatit për shkak të faktit që Drejtuesi ka vazhduar ushtrimin e detyrës deri në riemërim, bie ndesh me frymën e rendit kushtetues dhe administrativ, dhe krijon një precedent të rrezikshëm për legjitimimin e zgjatjes së mandatit pa bazë ligjore. Në këtë kontekst, për të respektuar parimet themelore të shtetit të së drejtës, për të ruajtur integritetin institucional të prokurorisë dhe për të garantuar standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare të administrimit të funksioneve publike, Këshilli duhet të pranojë, se: *mandati i Drejtuesit, në rastin e riemërimit, duhet të llogaritet duke filluar nga momenti kur ligjërisht ka përfunduar mandati i parë dhe jo, nga momenti kur është miratuar vendimi i riemërimit nga ana e Këshillit.*

90. Së fundi, Këshilli e vlerëson të ndalet në efektin që do të kishte në zhvillimin e karrierës së prokurorëve, zgjatja e mandatit të Drejtuesit të një prokurorie përtej afatit 3 (tre)-vjeçar të përcaktuar nga ligji.

91. Ligji për Statusin, në mënyrë të qartë dhe të prerë, ka përcaktuar në nenin 52, se mandati i Drejtuesit të prokurorisë është 3 (tre) vjet, me të drejtë riemërimi vetëm një herë dhe, se Këshilli duhet të marrë vendim për riemërim, jo më vonë se 3 (tre) muaj nga përfundimi i mandatit të parë.

92. Zgjatja përtej afatit të mandatit të një Drejtuesi, për shkak të vonesave institucionale, e kufizon praktikisht mundësinë e kandidimit të prokurorëve të tjerë për këtë funksion, duke përjashtuar padrejtësisht pjesën tjetër të trupës së magistratëve nga e drejta për zhvillim të mëtejshëm profesional. Kjo ndodh, sepse sipas nenit 47, të Ligjit për Statusin, Drejtuesi i një prokurorie përbën një pozicion të konsideruar si “ngritje në detyrë” dhe çdo vend i lirë për këtë pozicion, duhet të shpallet dhe t’u nënshtrohet procedurave të konkurrimit të hapur. Rrjedhimisht, mbajtja e pozitës përtej afatit të mandatuar, *pa shpallje dhe pa garë*, bie në kundërshtim me parimet themelore të procedurës së ngritjes në detyrë dhe pengon ushtrimin e të drejtës për konkurrim të prokurorëve të tjerë që mund të kishin aspiruar për këtë pozicion.
93. Nga një këndvështrim më i gjerë, kjo situatë përbën edhe një devijim nga standardet ndërkombëtare të përcaktuara nga Komisioni i Venecias dhe Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropianë, të cilat theksojnë se garancitë për zhvillimin e karrierës dhe procedurat transparente të emërimit, ngritjes në detyrë apo transferimit, janë pjesë e pandashme e statusit të pavarur të prokurorit.
94. Në rastin konkret, siç u analizua edhe më sipër, nuk ekziston asnjë dispozitë në Ligjin për Statusin që i lejon Këshillit të shtyjë mandatin e një Drejtuesi prokurorie përtej afatit 3 (tre)-vjeçar. Madje, ligji është i qartë në përcaktimin, se nëse Drejtuesi nuk riemërohet brenda afatit ligjor, pozicioni duhet të shpallet vakant dhe të fillojë procedura e konkurrimit përmes thirrjes për aplikim. Kjo do të thotë, se me kalimin e afatit të mandatit pa vendimmarrje, nuk kemi një zgjatje automatike të mandatit, por një detyrim për të hapur garën për pozicionin. Çdo veprim që shkon në drejtim të kundërt me këtë logjikë legislative, krijon një precedent të rrezikshëm të mbajtjes së kësaj detyre *pa garë dhe pa asnjë kriter*, duke shkelur të drejtën e prokurorëve të tjerë për zhvillim profesional.
95. Për rrjedhojë, çdo vendimmarrje për të lejuar zgjatjen e mandatit të një Drejtuesi përtej afatit të tij kushtetues dhe ligjor, në mungesë të një dispozite të posaçme që ta parashikojë këtë, do të përbënte një ndërhyrje të paligjshme në rregullat e *ngritjes në detyrë* dhe zhvillimit të karrierës së prokurorëve. Kjo jo vetëm që bie ndesh me standardet vendase dhe ndërkombëtare të pavarësisë së magistratëve, por edhe cenon besimin e publikut në integritetin dhe paanshmërinë e procesit të drejtimit të sistemit të prokurorisë.
96. Qëndrim të njëjtë ka mbajtur Këshilli, respektivisht, me vendimet me nr. 119, datë 23.06.2025 dhe nr. 279, datë 11.09.2025, për riemërimin e drejtuesve të zyrave të Prokurorisë Korçë dhe Elbasan, duke llogaritur fillimin e mandatit të dytë si drejtues nga momenti i mbarimit të kohës së rregullt të mandatit të parë në këtë detyrë.
97. Për këtë arsye Këshilli, me shumicë votash vendosi që, riemërimi i prokurorit, z. Albert Murçaj dhe mandati i dytë si Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër duhet të konsiderohet se ka filluar më datë

04.10.2024 (dita e parë pasi është plotësuar mandati i parë tre vjeçar) dhe duhet të përfundojë me datë 04.10.2027.¹

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenin 52, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166, pika 2, 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 56, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 29, të Vendimit nr. 200, datë 23.09.2020, “Për miratimin e Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të riemërojë prokurorin Albert Murçaj në pozicionin Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për një mandat tjetër tre vjeçar, mandat i cili përfundon në datë 04.10.2027.
2. Të ndërpresë caktimin e përkohshëm të z. Albert Murçaj si Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
3. Të njoftohen për këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe prokurori Albert Murçaj.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e njoftimit të vendimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 10.10.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji


¹ Votuan “pro” anëtarët Mirela Bogdani, Moisi Duda, Erind Merkuri, Zeqir Hoda, Erind Gërmenji dhe Erion Fejzulla; Votuan “kundër” anëtarët Sokol Stojani, Ledina Riza, Vatë Staka, Arta Mandro dhe Olger Eminaj



ANËTAR
Sokol Stojani
(kundër)



ANËTAR
Zeqir Hoda



ANËTAR
Arta Mandro
(kundër)




ANËTAR
Ledina Riza
(kundër)



ANËTAR
Moisi Duda



ANËTAR
Vatë Staka
(kundër)



ANËTAR
Olger Eminaj
(kundër)



ANËTAR
Erind Merkuri



ANËTAR
Erion Fejzulla